



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKTVENDIM**

Nr \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 60 DATË 21.12.2023 “PËR MIRATIMIN E  
BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2024 DHE PBA 2024-2026 ” i ndryshuar  
( për miratimin e financimit të projektit “Ndërtim i shkollës 9-vjeçare “22 Tetori” Berat dhe  
ambienteve të shërbimit dhe prishja e objektit ekzistues të shkollës “22 Tetori” )**

Këshilli Bashkiak Berat në mbledhjen e datës 28.03.2024 , pasi u njoh me materialin “Për një ndryshim në VKB nr. 60 datë 21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2024 dhe PBA 2024-2026 ” i ndryshuar ( për miratimin e financimit të projektit projektit “Ndërtim i shkollës 9-vjeçare “22 Tetori” Berat dhe ambienteve të shërbimit dhe prishja e objektit ekzistues të shkollës “22 Tetori”, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , të ligjit nr. 97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit plotësues nr. 1 datë 24.01.2024 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 60 datë 21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026” i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr 1815/3 dt. 11.03.2024 “ Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objekte shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin” i ndryshuar, VKB nr..... datë 28.03.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë bashkëfinancimin e bashkisë Berat për projektin “Ndërtim i shkollës 9-vjeçare “22 Tetori” Berat dhe ambienteve të shërbimit dhe prishja e objektit ekzistues të shkollës “22 Tetori”” në shumën 113,103,119 lekë dhe financimin prej 65,823,701.06 lekë për ndërtimin e ambienteve të shërbimit, total financim për këtë projekt shuma 178,926,820.06 lekë.

Financimi i Bashkisë Berat të kryhet në vitet 2024, 2025, 2026 si më poshtë :

- financimi i vitit 2024 vlera 25,000,000 lekë
- financimi i vitit 2025 vlera 80,000,000 lekë
- financimi i vitit 2026 vlera 73,926,820.06 lekë

2. Në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 60 datë 21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2024 dhe PBA 2024-2026” i ndryshuar , të bëhen ndryshimet (rishpërndarje e shpenzimeve) si më poshtë :

2.1 Në buxhetin e vitit 2024 shtohen me 10,000,000 lekë shpenzimet kapitale në programin buxhetor AC102 Arsimi&Kujdesi Social, në produktin P912AAO “Ndërtim i shkollës 9-vjeçare “22 Tetori” Berat dhe ambienteve të shërbimit dhe prishja e objektit ekzistues të shkollës “22 Tetori”” dhe pakësohen me 10,000,000 lekë shpenzimet kapitale në programin buxhetor AB102 Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile, produkti P452AAV “Investime të reja në infrastrukturën rrugore përfshirë shp. për supervizime&kolaudime,shpronësime”. Pas kësaj shtese, shpenzimet kapitale të programit AC102 për këtë produkt bëhen 25,000,000 lekë.

Shtesa :

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		<b>Bashkia Berat (Aparati)</b>				<b>10,000,000</b>
2102001		AC102	<b>Arsimi &amp; Kujdesi Social</b>			<b>10,000,000</b>
2102001	5	AC102	P912AAO	231	“Ndërtim i shkollës 9-vjeçare “22 Tetori” Berat dhe ambienteve të shërbimit dhe prishja e objektit ekzistues të shkollës “22 Tetori””, bashkefinansim me MAS	10,000,000
<b>Total i shtesave</b>						<b>10,000,000</b>

Pakësime:

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		<b>Bashkia Berat (Aparati)</b>				<b>10,000,000</b>
2102001		AB102	<b>Shërbimet Publike, Infrastruktura &amp; Emergjencat Civile</b>			<b>10,000,000</b>
2102001	5	AB102	P452AAV	231	Investime te reja ne infrastrukturën rrugore përfshire shp. per supervizime&kolaudime,shpronësime	10,000,000
<b>Total i Pakesimeve</b>						<b>10,000,000</b>

2.2 Në vitin 2025 shtohen me 80,000,000 lekë shpenzimet kapitale në programin buxhetor AC102 Arsimi&Kujdesi Social, në produktin P912AAO “Ndërtim i shkollës 9-vjeçare “22 Tetori” Berat dhe ambienteve të shërbimit dhe prishja e objektit ekzistues të shkollës “22 Tetori”” dhe pakësohen me 80,000,000 lekë shpenzimet kapitale në programin buxhetor AB102 Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile, produkti P452AAV “Investime të reja në infrastrukturën rrugore përfshirë shp. për supervizime&kolaudime,shpronësime”.

2.3 Në vitin 2026 shtohen me 73,926,820.06 lekë shpenzimet kapitale të programit buxhetor AC102 Arsimi&Kujdesi Social, në produktin P912AAO “Ndërtim i shkollës 9-vjeçare “22 Tetori” Berat dhe

8

ambienteve të shërbimit dhe prishja e objektit ekzistues të shkollës “22 Tetori” dhe pakësohen me 73,926,820.06 lekë shpenzimet kapitale të programit buxhetor AB102 Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile, produkti P452AA V “Investime të reja në infrastrukturën rrugore përfshirë shp. për supervizime&kolaudime,shpronësime”.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Investimeve, Drejtoria e Integritimit European dhe Projekteve.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ervin CECA**

